



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 31 gusht 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

**Vendimit për Caktimin e Rendit të Ditës të Seancës mbi Deklaratat Përmbyllëse
dhe Çështje në lidhje me To**

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim për caktimin e rendit të ditës të seancës mbi deklaratat përmbyllëse dhe çështje në lidhje me to.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 qershor 2022, Trupi Gjykues nxori Vendimin për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Çështje në lidhje me To, në të cilin, ndër të tjera: (i) planifikoi seancën për deklaratat përmbyllëse nga data 13 deri më 15 shtator 2022, dhe datën 16 shtator 2022 si ditë rezervë, me kohëzgjatje 5 orë e 30 minuta për ditë seance;¹ dhe (ii) urdhëroi Mbrojtjen e z. Salih Mustafa (përkatësisht, Mbrojtja dhe i akuzuari), Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe mbrojtësen e viktimave të dorëzonin parashtrime lidhur me kohëzgjatjen e përafërt që u nevojitej për deklaratat e tyre përmbyllëse, përfshirë dhe kohën që u nevojitej për të trajtuar aspektet e fajësisë apo të pafajësisë së të akuzuarit, dënimin dhe zhdëmtimet (tema e fundit është vetëm për Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave), deri më 23 gusht 2022.²
2. Më 23 gusht 2022, palët dhe mbrojtësja e viktimave dorëzuan parashtrimet e tyre.³

II. PARASHTRIMET

3. ZPS-ja vlerëson se deklarata përmbyllëse e vet do të zgjasë gjithsej 1 ditë (5.5 orë), nga të cilat 4.5 orë për aspekte që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të

¹ Katër seanca në ditë, si vijon: 09:30-11:00; 11:30-13:00; 14:30-16:00; 16:30-17:30.

² KSC-BC-2020-05, F00439, Trupi Gjykues I, *Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Çështje në lidhje me To*, 20 qershor 2022, publik, para. 22, 25.

³ KSC-BC-2020-05, F00464, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes lidhur me Argumentet Përmbyllëse* (Parashtrimet e Mbrojtjes), 23 gusht 2022, publike; F00465, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë lidhur me Kohëzgjatjen e Përafërt të Deklaratës së vet Përmbyllëse* (Parashtrimet e ZPS-së), 23 gusht 2022, publike; F00466, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Kohëzgjatjen e Përafërt të Deklaratave Përmbyllëse* (Parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave), 23 gusht 2022, publike.

akuzuarit dhe 1 orë për aspekte që kanë të bëjnë me dënimin.⁴ ZPS-ja rezervon të drejtën për t'iu përgjigjur çdo aspekti të ngritur nga Mbrojtja në deklaratën e saj përmbyllëse.⁵

4. Mbrojtësja e viktimave vlerëson se deklarata përmbyllëse e saj do të zgjasë gjithsej jo më shumë se 2 orë, nga të cilat 1 orë për aspekte që kanë të bëjnë me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit dhe dënimin, dhe 1 orë për aspekte që kanë të bëjnë me zhdëmtimin.⁶ Gjithashtu, mbrojtësja e viktimave parashtron se do t'i duhet një pushim prej rreth 60 minutash pas deklaratës përmbyllëse të ZPS-së që të përshtatë deklaratën e vet përmbyllëse paraprake për të shmangur përsëritjet e panevojshme.⁷

5. Mbrojtja vlerëson se deklarata përmbyllëse e saj do të zgjasë gjithsej 1 ditë (5.5 orë), nga të cilat 4.5 orë për aspekte që kanë të bëjnë me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit dhe dënimin, dhe 1 orë për aspekte që kanë të bëjnë me zhdëmtimin.⁸ Mbrojtja njofton se i akuzuari nuk do ta ushtrojë të drejtën e tij për të folur i fundit, në përputhje me rregullën 135(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykues mbështetet në nenin 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5) dhe 135 të Rregullores.

⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1-2.

⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

⁶ Parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave, para. 2, 4.

⁷ Parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave, para. 3.

⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2.

⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3.

IV. ANALIZË

A. RENDI I DITËS

7. Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve dhe mbrojtëses së viktimave, Trupi Gjykses cakton rendin e ditës në vijim për seancën e deklaratave përmbyllëse, që mund të ndryshohet nga Trupi Gjykses gjatë seancës, ose *proprio motu*, ose me kërkesë të një pale apo të mbrojtëses së viktimave, sipas rastit:

- a. 13 shtator 2022: Deklarata përmbyllëse e ZPS-së (5.5 orë; nga të cilat 4.5 orë për fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, dhe 1 orë për dënimin;
- b. 14 shtator 2022:
 - i. Deklarata përmbyllëse e mbrojtëses së viktimave në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit dhe dënimin (1 orë);
 - ii. Deklarata përmbyllëse e Mbrojtjes në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit dhe dënimin (4.5 orë);
- c. 15 shtator 2022:
 - i. Përgjigjja e ZPS-së (45 minuta) dhe të mbrojtëses së viktimave (45 minuta) ndaj aspekteve të ngritura nga Mbrojtja në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit dhe dënimin;
 - ii. Komentet e Mbrojtjes ndaj përgjigjeve të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave (45 minuta);
 - iii. Pyetje nga Trupi Gjykses, nëse do të ketë (1 orë);
 - iv. Deklarata përmbyllëse e mbrojtëses së viktimave në lidhje me zhdëmtimet (1 orë);
 - v. Deklarata përmbyllëse e Mbrojtjes lidhur me zhdëmtimet (1 orë);
- d. 16 shtator 2022 (vetëm në rast nevojë; mbrojtësja e viktimave dhe Mbrojtja duhet të jenë të gatshëm të vazhdojnë më 15 shtator, në qoftë se lejon koha):

- i. Përgjigja e mbrojtëses së viktimave në lidhje me zhdëmtimet (45 minuta);
- ii. Komentet e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së mbrojtëses së viktimave në lidhje me zhdëmtimet (45 minuta);
- iii. Pyetje nga Trupi Gjykses, nëse do të ketë (1 orë); dhe
- iv. Mbyllja e çështjes gjyqësore.

B. PYETJE DHE UDHËZIME

8. Për të arritur në një përfundim të bazuar lidhur me akuzat kundër të akuzuarit dhe pa paragjykim ndaj pyetjeve të mëtejshme që Trupi Gjykses mund t'u bëjë palëve dhe/ose mbrojtëses së viktimave gjatë seancës, Trupi Gjykses kërkon parashtrime dhe sqarime të mëtejshme mbi disa aspekte të rëndësishme për çështjen. Pyetjet nuk paragjykojnë konstatimet e bëra në aktgjykim. Ndërsa disa nga pyetjet i drejtohen kryesisht njëres palë ose mbrojtëses së viktimave, kjo nuk e pengon palën kundërshtare dhe/ose mbrojtësen e viktimave që të bëjnë parashtrime në lidhje me to.

9. Kur të bëjnë parashtrime për ndonjë nga pyetjet në vijim, palët dhe mbrojtësja e viktimave mund të mbështeten në provat ekzistuese që ka Trupi Gjykses për aktgjykimin, përfshirë provat fotografike.

1. Ndalimi arbitrar (Pika 1); Pyetje për ZPS-në

10. Cilat nga ndërtesat konkrete të cilat ndodhen në vendin që ZPS-ja e quan kompleksi i ndalimit në Zllash,¹⁰ pretendohet se janë përdorur për mbajtjen të ndaluar,

¹⁰ KSC-BC-2020-05, F00459/COR/A01, Prokurori i Specializuar, *Version i Korrigjuar i Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Prokurorisë në Përputhje me Rregullën 134(b)* (Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së), 22 korrik 2022, konfidenciale, para. 22, dhe provat e përmendura në f. 12-13 të Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së.

marrje në pyetje dhe/ose keqtrajtimin e individëve gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat?

2. Përcaktimi i dënimit, në qoftë se do të jepet dënim; Pyetje për palët dhe mbrojtësen e viktimave

11. Pyetja 1: Sipas nenit 44(2)(b) të Ligjit, a e ka për detyrë Trupi Gjykses të zbatojë “ndonjë shkallëzim të mëtejshëm dënimi më të butë për krimin e parashikuar në ligjin e Kosovës”? Apo shprehja “e marrin parasysht” në paragrafin (2) të nenit 44 të Ligjit sugjeron se Trupi Gjykses duhet të bazohet vetëm në një shkallëzim të tillë të mëtejshëm dënimi më të butë, nëse do të jepet dënim?

12. Pyetja 2: Neni 44(2)(b) i Ligjit përmend ndonjë shkallëzim të mëtejshëm dënimi më të butë për “krimin” e parashikuar në legjisllacionin e Kosovës. Në rast se “krimi” për të cilin i akuzuari është shpallur fajtor nuk parashikohet në legjisllacionin e Kosovës, por vetëm në të drejtën zakonore ndërkombëtare – dhe si rrjedhojë nuk përkon me ndonjë shkallëzim të mëtejshëm dënimi më të butë për krimin e parashikuar në legjisllacionin e Kosovës – çfarë legjisllacioni tjetër të zbatueshëm, në qoftë se ekziston, duhet të marrë parasysht Trupi Gjykses gjatë përcaktimit nëse ka shkallëzim të mëtejshëm dënimi më të butë për një krim të tillë?

13. Pyetja 3: Bazuar në nenin 44(2)(c) të Ligjit, në çfarë rrethanash “ndëshkimi i një veprimi ose mosveprimi i cili ishte kriminal sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara do të paragjykohej prej zbatimit të paragrafit 2 (a) dhe (b)” të nenit 44 të Ligjit?

14. Pyetja 4: Në qoftë se Trupi Gjykses vepron në përputhje me nenin 44(2)(b) të Ligjit, a është i zbatueshëm neni 38 i Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i vitit 1976 (Kodi Penal i RSFJ-së) dhe, në qoftë se është, cilët paragrafë të kësaj dispozite janë të zbatueshëm?

3. Zhdëmtimet, në qoftë se do të ketë; Udhëzime për mbrojtësen e viktimave

15. Trupi Gjykses vë në dukje se mbrojtësja e viktimave ka renditur kategoritë në vijim në lidhje me dëmin e shkaktuar viktimave: (i) dëmin fizik ose mendor; (ii) mundësitë e humbura, përfshirë punësimin, arsimimin dhe ndihmat sociale; (iii) dëmet materiale dhe humbjen e të ardhurave, përfshirë humbjen e të ardhurave të mundshme; dhe (iv) dëmin moral.¹¹ Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se neni 22(1) i Ligjit përmend tri lloje të dëmit, përkatësisht dëmin fizik, mendor dhe material.¹²

16. Pyetja 1: Në lidhje me [REDAKTUAR], për çfarë lloj (llojesh) dëmi (dëmi fizik, mendor dhe material) kërkon zhdëmtim mbrojtësja e viktimave? Mbrojtësja e viktimave udhëzohet që për secilën viktimitë të hartojë kërkesat për zhdëmtim sipas tri llojeve të dëmit të përmendur më lart.

17. Më tej, Trupi Gjykses vë në dukje se mbrojtësja e viktimave kërkon që viktimave t'u jepet kompensim si zhdëmtim dhe bën të ditur shumat *minimale* të të hollave që duhet dhënë pa bërë dallim apo saktësuar llojet e dëmit me të cilat lidhen këto shuma konkretisht.¹³

¹¹ KSC-BC-2020-05, F00444/COR, Mbrojtësja e Viktimave, *Version i Korrigjuar i Kërkesës së Hollësishme dhe Përmbledhëse të Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim*, 4 korrik 2022 (data në origjinal është 30 qershor 2022), rreptësisht konfidencial (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim), para. 8. *Shih gjithashtu* Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, para. 58-59.

¹² *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00105, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), 30 prill 2021, konfidencial, para. 34-35, në të cilin Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi tri llojet e dëmit (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00105/RED). Trupi Gjykses sqaron se dëmi mendor përfshin dëmin psikologjik edhe moral (Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave), para. 35. *Shih gjithashtu* ICC, *The Prosecutor v. Bosco Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-2659, Trial Chamber VI, Reparations Order, 8 March 2021, para. 70 referring to ICC, *The Prosecutor v. Germain Katanga*, ICC-01/04-01/07-3728-tENG, Trial Chamber II, *Order for Reparations pursuant to Article 75 of the Statute*, 24 March 2017, para. 57, fn. 103).

¹³ [REDAKTUAR] (*Shih* Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, para. 37-38; KSC-BC-2020-05, F00440/A01, Mbrojtësja e Viktimave, *Shtojca 1 e Raportit të Parashtruar prej të Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Humbjet Ekonomike*, 23 korrik 2022, konfidenciale [Raporti për Humbjet Ekonomike]). [REDAKTUAR] (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, para. 43, theksimi i shtuar). [REDAKTUAR] (Kërkesa e Mbrojtjes së Viktimave për Zhdëmtim, para. 48). [REDAKTUAR] (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtimin, para. 57, 59).

18. Pyetja 2: Për të ndihmuar Trupin Gjykses në përcaktimin e shkallës dhe përmasat e dëmit, humbjes dhe lëndimit të pësuar nga viktimat (neni 22(7) i Ligjit),¹⁴ cilat janë shumat e të hollave për çdo lloj dëmi (dëmi fizik, mendor dhe material), që do t'i jepen [REDAKTUAR] për të kompensuar dëmin e shkaktuar këtyre viktimave? Mbrojtësja e viktimave udhëzohet të bëjë të ditur për secilën viktimë dhe për çdo lloj dëmi shumën e të hollave që do t'u jepet, në rast se i akuzuari do të dënohet.

19. Trupi Gjykses vë në dukje sugjerimin e mbrojtëses së viktimave që Trupi Gjykses të bëjë një vlerësim të drejtë të "dëmit jomaterial" në pajtim me standardet në të drejtën shtetërore dhe ndërkombëtare.¹⁵ Duke pasur parasysh faktin se disa lloje të dëmit mund të përcaktohen në vlerë monetare, ndërsa për të tjerat nuk mund të bëhet llogaritje e saktë, Trupi Gjykses udhëzon mbrojtësen e viktimave gjithsesi që për këto lloje dëmsh të bëjë të ditur shumën e të hollave që viktimat e konsiderojnë të përshtatshme për të kompensuar dëmin e shkaktuar.

20. Trupi Gjykses udhëzon mbrojtësen e viktimave të dorëzojë informacionin e kërkuar, të përmendur në paragrafët 16-19 më lart, me shkrim në vend të, ose krahas, deklaratave përmbyllëse, jo më vonë se **të mërkurën, 7 shtator 2022**. Gjithashtu, Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen të dorëzojë parashtrime me shkrim, nëse dëshiron, deri në **mesditën e të hënës, 12 shtator 2022**.

¹⁴ *Shih në lidhje me këtë, ICC, The Prosecutor v. Bosco Ntaganda, ICC-01/04-02/06-2659, Trial Chamber VI, Reparations Order, 8 March 2021, paras 96-98 and references therein.*

¹⁵ KSC-BC-2020-05, Transkript, 21 mars 2022, publik, f. 2544 rreshti 23, deri në f. 2545 rreshti 5. *Shih gjithashtu Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, para. 8, 14-23, 51-55.*

V. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykes:

- a. **CAKTON** rendin e ditës për seancën lidhur me deklaratat përmbyllëse sikurse përcaktohet në paragrafin 7; dhe
- b. **URDHËRON** palët dhe mbrojtësen e viktimave të bëjnë parashtrime sikurse përmendet në paragrafët 7-20 më lart.

/nënshkrimi/
Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/
Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/
Gjykatës Roland Dekers

E mërkurë, 31 gusht 2022

Në Hagë, Holandë.